



Menaxhimi Financiar, Kontabilitet dhe Kontrolli – Zhvillimi i Kurrikulave për Ngritjen e Kapaciteteve të Administratës Publike

Raport i Kërkimit 1.4.- SHQIPËRIA

Hartëzimi i njohurive dhe ekspertizës së trajnuesve në universitetet partnere në projekt



Co-funded by the
Erasmus+ Programme
of the European Union

Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian. Ky publikim reflekton pikëpamjet e autorit dhe Komisioni European nuk mund të mbahet përgjegjës për përdorimin që mund t'i bëhet informacionit që gjendet në këtë raport kërkimor.

Përmbajtja

Hyrja	3
Metoda	4
Rezultatet.....	5
Përkatësia akademike, titujt akademik dhe lëndët mësimore.....	5
Arsimi.....	7
Zhvillimi profesional i mëtejshëm	8
Pjesëmarrja në projekte zhvillimore dhe kërkimore	8
Fushat e ekspertizës.....	9
Nevoja për zhvillim profesional.....	10
Përfundime.....	11
Shtojca 1: Lista e referencave	13
Referenca nga UET	13
Referenca nga Universiteti "Luigj Gurakuqi"	14
Shtojca 2: Pyetësor	17

Hyrja

Ky raport shkruhet në kuadër të projektit Menaxhimi Financiar, Kontabilitet dhe Kontrolli – Zhvillimi i Kurrikulave për Ngritjen e Kapaciteteve të Administratës Publike (FINAC), projekt i programit Erasmus+ të Bashkimit Europian, nën programi Zhvillimi i Kapaciteteve në Arsimin e Lartë. Raporti është produkt i Paketës së Parë të Punës të projektit FINAC: Hartëzimi dhe raportimi i kapaciteteve aktuale të punonjësve të administratës publike në Shqipëri dhe Serbi. Projekti zbatohet në Shqipëri dhe në Serbi dhe konsortiumi përbëhet nga 12 partnerë nga Shqipëri, Serbia dhe katër vendet e Bashkimit Europian.¹ Institucioni koordinues i projektit është Universiteti i Beogradit, Fakulteti i Shkencave Organizative.

Fokusi kryesor i “Menaxhimi Financiar, Kontabilitet dhe Kontrolli - Zhvillimi i Kurrikulave për Ngritjen e Kapaciteteve të Administratës Publike” (FINAC), është të japi një kontribut për të rritur cilësinë e buxhetimit, menaxhimit të parasë, menaxhimit financiar, kontabilitetit dhe kontrollit në Administratën Publike në Shqipëri dhe Serbi. Objektivat specifike të këtij projekti janë: (i) të hartojë dhe zhvillojë tre programe të reja masteri në Serbi dhe dy programe të reja masteri në Shqipëri në fushat e menaxhimit financiar, kontabilitetit dhe kontrollit në Administratën Publike në Shqipëri dhe Serbi; (ii) të ofrojë trajnime në Qendrat Universitare/Institute për punonjësit e Administratës Publike në Serbi e Shqipëri; (iii) Modernizimi i njërës prej programeve master në fushën e Menaxhimit Financiar Publik në Serbi.

Në kuadër të paketës së punës 1, projekti FINAC parashikon tetë raporte si produkte konkrete bazuar në një proces kërkimor të dakordësuar mes gjithë partnerëve: 4 raporte për Serbinë dhe 4 për Shqipërinë:

- Raporti 1.1: Hartëzimi i nivelit aktual të dijeve të punonjësve të administratës publike në fushën e menaxhimit financiar, kontabilitetit dhe kontrollit;
- Raporti 1.2: hartëzimi i strukturës së kualifikimeve aktuale të punonjësve të administratës publike në fushën e menaxhimit financiar, kontabilitetit dhe kontrollit;
- Raporti 1.3: Rezultatet mësimore dhe harmonizimi i strategjive kombëtare me direktivat e BE-së për administratën publike në këtë fushë;
- Raporti 1.4: Hartëzimi i nivelit aktual të dijeve dhe ekspertizës së trajnuesve në universitetet partnere në projekt.

Ky raport në mënyrë specifike adreson pikën 1.4 të paketës së parë të punës: • Raporti 1.4: Hartëzimi i nivelit aktual të dijeve dhe ekspertizës së trajnuesve në universitetet partnere në projekt – dhe në mënyrë të veçantë për partnerët në Shqipëri². Qëllimi i këtij raporti është që të paraqes një tablo të ekspertizës aktuale të profesorëve në universitetet partnere në projekt në fushat e lidhura me FINAC, si edhe me ato trajnues apo akademikë që janë të angazhuar në zhvillimin dhe zbatimin e programit të masterit në universitetet partnere në Shqipëri për projektin në fjalë. Kjo gjithashtu nënkupton edhe parashtrimin e nevojave për zhvillim të mëtejshëm profesional si bazë për të hartuar

¹ Partnerët e projektit janë: Universiteti i Beogradit (Koordinator), Universiteti Europian i Tiranës, Universiteti i Kragujevac, Universiteti Shtetëror i Novi Pazar, Universiteti Singidunum, Ministria e Administratës Publike dhe Qeverisjes Lokale, Beograd; Qendra për Politika Edukimi; Universiteti Luigj Gurakuqi, Shkoder; Universitetit i Split; Universiteti Marconi; Universiteti Masaryk; Fakulteti i Ekonomisë në Universitetin Matej Bel. Më shumë rreth projektit gjeni në - <http://finac.org.rs/>

² Raporti për nivelin e dijes dhe ekspertizës së trajnuesve në universitetet rajonale partnere të projektit në Serbi paraqitet në një tjetër dokument.


aktivitetet e tjera të projektit dhe sidomos vizitat studimore në universitetet partnere në vendet e BE-së.

Partneri që drejton këtë paketë pune dhe që është përgjegjës për hartimin e procesit kërkimor, organizimin, administrimin, analizën e të dhënave dhe më pas shkrimin e raporteve ishte Qendra për Politika Edukimi (CEP) nga Beogradi, Serbi. Për pjesën e kërkimit të realizuar për rastin e Shqipërisë, partneri kryesor dhe përgjegjës për këtë ishte Universiteti European i Tiranës – përfaqësuesit e tij në projekt ishin përgjegjës për planifikimin dhe zbatimin e procesit të kërkimit në rastin e Shqipërisë. Në përgjithësi koordinimi i procesit kërkimor u bë në të dy vendet dhe u mbështet nga institucioni koordinues – Fakulteti i Shkencave Organizative në Universitetin e Beogradit.

Metoda

Mbledhja e të dhënave u bë në formën e një pyetësoi online duke përdorur platformën Qualtrics (www.qualtrics.com). Pyetësoi zgjati tre jëvë – përgjigjet e para erdhën në 15 Maj, dhe të fundit në 8 qershor 2017. Pjesëmarrësit në dy universitetet partnere në projekt nga Shqipëria (Universiteti European i Tiranës/ Fakulteti i Ekonomisë dhe Teknologjisë së Informacionit dhe Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"/ Fakulteti i Ekonomisë) u kontaktuan përmes koordinatorëve lokal të projektit – ata morrën një email me linkun e pyetësoit në të. Në total 34 akademikë plotësuan pyetësoin – 20 nga Universiteti European i Tiranës dhe 14 nga Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" (Figura 1).

Figura 1: Përkatësia akademike e pjesëmarrësve në pyetëso



Në mënyrë që të matej apo hartëzohej ekspertiza e akademikëve të përfshirë në projektin FINAC, një pyetësoi u zhvillua nga Qendra për Politika Edukimi, partner në projektin FINAC dhe lider i paketës së parë të punës. Pyetësoi përmbante disa kategori pyetje të lidhura me fushat si më poshtë:

- Titulli
- Lëndët që jep mësim
- Arsimimi

- Zhvillimi i mëtejshëm profesional / karriera akademike
- Pjesëmarrja në projekte kërkimore dhe projekte të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare
- Lista e publikimeve kryesore

Pyetësi i lejonte të anketuarve të shprehnin mendimin e tyre lidhur me se cilat janë fushat e tyre të ekspertizës. Për më tepër, të anketuarit u pyetën edhe rreth temave specifike për projektin FINAC për të cilat kanë interes për të përmirësuar aftësi të tyre.

Rezultatet

Përkatesia akademike, titujt akademik dhe lëndët mësimore

Sipas planit të kampionimit, të gjithë akademikët që morrën pjesë në pyetësor janë staf akademik i dy universiteteve shqiptare partnerë në projekt: Universiteti Europian i Tiranës (më tej në tekst UET) and Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" (më tej në tekst ULGSH). Të gjithë ata që iu përgjigjën pyetësorit i përkasin Fakultetit të Ekonomisë dhe Teknologjisë së Informacionit në UET dhe Fakultetit të Ekonomisë në ULGSH.

Akademikët nga Fakulteti i Ekonomisë në ULGSH i përkasin tre departamenteve: Departamenti për Administrim Biznesi (3 respondentë), Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit (9 respondentë) dhe Departamenti i Turizmit (2 respondentë). Akademikët që i përkasin Fakultetit të Ekonomisë dhe Teknologjisë së Informacionit në UET, që iu përgjigjën pyetësorit i përkasin dy departamenteve: Financa dhe Ekonomia (9 respondentë) dhe Departamenti i Manaxhimit dhe Marketingut (11 respondentë). Krahas lidhjes së tyre kryesore me një universitet, dy profesorë nga ULGSH punojnë edhe për universitete të tjera – një punonte edhe për Universitetin Ukshin Hoti në Prizren dhe një tjetër për Universitetin Aleksandër Moisiu në Durrës, Fakulteti i Biznesit.

Sa i takon titujve akademikë të respondentëve në pyetësor, shumica janë profesor të asociuar, më pas asistent profesorë, asistent lektorë dhe në fund profesor doktor. Për dy prej respondentëve informacioni mungon. Tabela 1 më poshtë paraqet ndarjen sipas universiteteve dhe titujve akademik.

Tabela 1: Ndarja e titujve akademikë sipas universiteteve në pyetësor

Titulli	Universiteti Europian i Tiranës*	Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	Totali
Profesor	2	2	4
Profesor i Asociuar	8	5	13
Asistent Profesor	3	5	8
Asistent lector	5	2	7

*Mungojnë dy të dhëna

Sa i takon kurseve apo programeve ku ata japin mësim, ka një shpërndarje në nivelin e BA, MA dhe PhD në të dy universitetet. Së pari, në nivelin Bachelor në Departamentin e Financës dhe Ekonomiksit në UET, lëndët që akademikët japin mësim janë: Taksimi dhe Investimet; Makroekonomi dhe Mikroekonomi; Hyrje në Financë dhe Financat Publike; Kontabiliteti Financiar dhe Manaxherial; Kontabiliteti i Kostos, Paraja, Banka, dhe Tregjet Financiare; Analiza financiare dhe financat e sipërmarrjes si edhe Kontabiliteti Bankar dhe Hyrje në Manaxhimin e Riskut.

Sa i takon nivelit të masterit, në të njëjtin departament si mësipër, lëndët janë: Kontroll i Brendshëm dhe Auditim; Qeverisja, Riskut dhe Etika; Politikat Fiskale dhe Sistemi i Taksave; Markoekonomi

dhe Mikroekonomi e avancuar; Kontabilitet Kombëtar; Tregjet e Kapitaleve dhe Financiare; Bankingu dhe institucionet e tij; Banka Qendrore dhe Politika Monetare; Qeverisja e Korporatës; Politika Ekonomike Ndërkombëtare; Biznes Ndërkombëtar; Ekonomia e BE-së; Manaxhimi Financiar Ndërkombëtar dhe Auditimi i Brendshëm i Bankave.

Profesorët nga ky department që iu përgjigjën pyetësorit, gjithashtu japin mësim në nivel doktrate për lëndën Financat Publike.

Profesorët nga Departamenti i Manaxhimit dhe Marketing që plotësuan pyetësorin japin mësim në nivel Bachelor: Hyrje në Administrim Biznesi; Politika Publike dhe Menaxhimi i Rrezikut; Sjellja e konsumatorit; Bazat e Marketingut dhe Menaxhimit të Marketingut; Dizajnimi dhe Menaxhimi i Projekteve; Makroekonomia dhe Mikroekonomia; Menaxhimi i Burimeve Njerëzore; Ndërmarrjet dhe Menaxhimi i NVM-ve; Historia e Mendimit Ekonomik dhe Komunikimi Organizativ.

Lëndët që japin profesorët nga ky departament në nivel Masteri janë: Aftësi menaxheriale; Menaxhimi i Cilësisë; Vlerësimi i Politikës Publike; Menaxhimi Strategjik; Menaxhimi dhe Vlerësimi i Projekteve; Menaxhimi dhe Administrimi i Sektorit Publik; Tregjet dhe Strategjia e Turizmit; Marketingu i Bankave dhe Sigurimeve; Mikroekonomia e avancuar; Banka Qendrore dhe Politika Monetare; Reklamim dhe Promovim; Komunikimi i Integruar i Marketingut; Biznesit ndërkombëtar; Politika financiare; Metodatat e avancuara të hulumtimit; Hulumtimi i Marketingut; Shërbimet e marketingut; Komunikimi në Biznes; Financimi i programeve dhe projekteve nga BE.

Profesorët nga ky departament japin edhe mësim në nivel doktrate për lëndën: Teori e Avancuar e Menaxhimit.

Në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Departamenti i Financave dhe Kontabilitetit, lëndët në nivelin BA nga profesorët që plotësuan pyetësorin on-line janë: Drejtimi Financiar; Drejtimi i Investimeve; Shërbimet e Sigurisë dhe Konsulencës; Sjellja e Investitorëve; Ekonomia e sektorit publik; Ekonomia Ndërkombëtare; Ekonomia e Transportit; Kostot e Kontabilitetit dhe Menaxhimi; Tatimet dhe të Drejtat e Biznesit; Tregjet dhe Institucionet Financiare; Menaxhimi i Projekteve; Kontabiliteti; Kontabiliteti i Menaxhimit; Kontabiliteti financiar; Analiza Financiare; Parimet e Kontabilitetit; Kontabiliteti financiar; Bazat e Financave; Parimet e Financave dhe Investimeve; Financimi i Fondit; dhe Financat Ndërkombëtare.

Kurset e dhëna në nivelin MA janë si më poshtë: Financimi i Korporatave; Kontabiliteti i Menaxhimit; Etika në Kontabilitet; Menaxhimi i Sigurimeve; Tregu Ndërkombëtar i Kapitalit; Menaxhimi i avancuar i kontabilitetit; Vlerësimi i Projekteve të Investimeve; Tregjet dhe Institucionet Financiare; Menaxhimi i rrezikut; Menaxhimi i Sigurimeve; Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Kontabilitetit; Analiza e Pasqyrave Financiare; Analiza e kredive; Kontabiliteti publik; Kontabiliteti i avancuar financiar; Kontabiliteti i Avancuar Bankar; Drejtimi Financiar; Teoria e Portfolios; Modelimi Financiar.

Në nivel doktrate, kursi është Makroekonomi e Avancuar.

Profesorët e lidhur në Departamentin e Administrim Biznesit në të njëjtin universitet që kanë plotësuar sondazhin on-line japin kurset e mëposhtme në nivelin BA: Biznes Ndërkombëtar; Menaxhimi i Biznesit; Menaxhimi i Cilësisë; Menaxhimi i Burimeve Njerëzore.

Në nivelin MA, këto kurse ofrohen nga akademikët të cilët kanë plotësuar pyetësorin on-line: Biznes Ndërkombëtar; Menaxhimi i Biznesit Global; Menaxhimi Financiar i IME; Menaxhimi i NVM-ve dhe Sipërmarrësve të Rinj; Menaxhimi i Cilësisë për NVM-të, dhe Sjellja Organizative.

Së fundi, akademikët e lidhur me Departamentin e Turizmit, të cilët morën pjesë në studim, japin mësim në kurset e mëposhtme në nivelin BA: Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit; Softueri i Aplikuar në Financat, Menaxhimi i Hoteleve dhe Sistemet e Rezervimit.

Në nivelin MA, profesorët që morën pjesë në këtë studim po japin mësim në kurset e mëposhtme: Teknologjia e Informacionit në Biznes; Sistemet e Informacionit Bankar; Sistemet e Informacionit Kontabël; Teknologjia e Informacionit për Turizmin Kulturor; Menaxhimi i Qëndrueshëm i Destinacioneve; Menaxhimi i Marketingut; Marketingu Ndërkombëtar i Turizmit.

Arsimi

Në pjesën në vazhdim të pyetësorit, akademikëve iu kërkua që të jepnin informacion lidhur me nivelin e parë, të dytë dhe të tretë të arsimit të tyre si edhe të emëronin universitetin dhe fakultetin ku kanë marrë diplomat.

Pedagogët që iu përgjigjën pyetësorit nga UET në shumicën e tyre i kanë marrë diplomat nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë. Megjithatë, ka të tjerë që morrën diplomat e arsimit nga universitete të tjera në Shqipëri si Universiteti Bujqësor i Tiranës, Universiteti Politeknik i Tiranës, Universiteti "Luigj Gurakuqi" në SHkodër dhe Universiteti "Aleksandër Xhuvani" në Elbasan. Dy pedagog ishin diplomuar në universitete të huaja jashtë Shqipërisë si Universiteti i Bordosë dhe Universiteti i Strasburgut.

Edhe diplomat e nivelit të dytë si psh master në rastin e pedagogëve në UET janë marrë nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë. Megjithatë, diversiteti i diplomave në këtë rast është më i madh sesa në rastin e diplomave Bachelor. Ka më shumë diploma të marra në universitete të ndryshme në Shqipëri si nga UET, Universiteti Politeknik i Tiranës, Universiteti "Luigj Gurakuqi" në SHkodër si edhe nga universitete të huaja si Universiteti i Strasburgut, Universiteti i Nebraska-Lincoln, Universiteti Johns Hopkins, Universiteti i Bambergut, dhe Universiteti Tuscia.

Sa i takon diplomave të nivelit të tretë (PhD), shumica janë doktoruar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë si edhe në vetë UET dhe në Universitetin Politeknik i Tiranës. Dy pedagogë janë doktoruar jashtë në Universitetin Tuscia dhe Universitetin e Seviljes.

Kur është fjala për Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi", profesorët kanë fituar gradën e parë të nivelit të lartë kryesisht nga e njëjti universitet (Fakulteti i Ekonomisë), pasuar nga Universiteti i Tiranës dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës. Një diplomë u siguroi jashtë vendit - në Universitetin e Prishtinës. Sa i përket gradave të nivelit të dytë shumica e gradave të nivelit të dytë janë përsëri nga Universiteti i Tiranës dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës (Fakulteti i Ekonomisë), por ka një numër të diplomave të fituara në vendet e huaja, përkatësisht nga: Universiteti i Beogradit, Universiteti i Southern Illinois dhe Universiteti Sapienza i Romës. Së fundi, shumica e gradave të doktoratës janë nga Universiteti i Tiranës, e ndjekur nga Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe Universiteti Aleksander Moisiu, Durrës. Ekzistojnë gjithashtu disa grada doktorature të fituara jashtë vendit - në Universitetin e Podgoricës (tani Universiteti i Malit të Zi), Universitetin Sapienza të Romës dhe Universitetin e Trentos (zakonisht në Fakultetin Ekonomik).

Zhvillimi profesional i mëtejshëm

Profesorëve nga dy universitete shqiptare iu kërkua gjithashtu që të emërojnë tre aktivitete më të rëndësishme të zhvillimit profesional ('në shërbim') që kishin deri më tani - nga këto aktivitete (trajnime, seminare, etj.). Ata duhej të përshkruanin se çfarë lloj aktiviteti ishte dhe cila ishte tema kryesore, si dhe ku ishte aktiviteti i mbajtur, në cilin institucion, kur ishte bërë dhe për sa kohë.

Rezultatet e mbledhura nga Universiteti European i Tiranës tregojnë se shumica e aktiviteteve që lidhen me zhvillimin e mëtejshëm profesional të profesorëve janë bërë jashtë Shqipërisë dhe zgjati deri në një javë. Nga 19 aktivitete të përshkruara të zhvillimit profesional, vetëm dy ishin të lidhura drejtpërdrejt me temat relevante për projektin FINAC. I pari ishte rreth sfidave kryesore në zbatimin e menaxhimit financiar dhe auditimit të brendshëm. Aktiviteti u zhvillua në Slloveni në vitin 2011 dhe zgjati deri në një javë. E dyta ka të bëjë me auditimin dhe kontrollin financiar dhe është zbatuar në Shqipëri në 2011. Aktivitete të tjera ndryshojnë në aspektin e temave, kohëzgjatjen e trajnimit dhe vendin ku është organizuar aktiviteti. Ato zakonisht zgjasin deri në një muaj dhe zakonisht u zhvilluan në formë të konferencave ose trajnimeve në Itali, Gjermani, Austri, Poloni, Hungari apo SHBA. Shumica e këtyre aktiviteteve të zhvillimit profesional ishin në lidhje me metodat e mësimdhënies dhe kërkimet, taksat dhe bankat ose administratën publike në përgjithësi. Së fundi, shumica e aktiviteteve janë kryer pas vitit 2010, por ka edhe ato që janë zbatuar gjatë viteve 1990 apo 2000.

Të dhënat e mbledhura nga Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" sugjerojnë tendenca të ngjashme në drejtim të zhvillimit të mëtejshëm profesional. Përsëri, trajnimi shtesë ishte bërë jashtë Shqipërisë më shpesh sesa brenda vendit, duke përfshirë vende të tilla si Italia, Serbia, Polonia, Mali i Zi, SHBA, Spanja etj., dhe zgjat në shumicën e rasteve deri në një javë ose deri në një muaj. Kur bëhet fjalë për rëndësinë e temave të mbuluara të këtyre trajnimeve për projektin FINAC, vetëm në një rast trajnimi ka të bëjë me kontabilitetin dhe është zbatuar dy herë në Shqipëri: në vitin 2012 dhe 2016. Në shembuj të tjerë, zhvillimi profesional lidhej kryesisht për praktikatat e mësimdhënies dhe hulumtimit, që zgjasin mes një jave dhe një muaji. Në shumë raste profesorët e Universitetit të Shkodrës shprehën përvojën e tyre të mësimdhënies në universitetet e huaja si zhvillim të mëtejshëm profesional, si dhe në disa raste master dhe doktoraturë. Këto aktivitete zakonisht zgjatën më shumë se një vit. Të gjitha aktivitetet e përshkruara të zhvillimit profesional ndodhën midis 2005 dhe 2017.

Pjesëmarrja në projekte zhvillimore dhe kërkimore

Në pjesën e ardhshme të pyetësorit, pedagogëve të dy universiteteve iu kërkua të japin informacion për pjesëmarrjen e tyre në projekte kërkimore dhe zhvillimore. Akademikët pritët të japin informacion mbi titullin e projektit dhe të përshkruajnë shkurtimisht temën e saj kryesore. Gjithashtu, ata pritej të japin informacion mbi fushëveprimin e projektit (a ishte ai kombëtar, rajonal, evropian apo ndërkombëtar), periudha e zbatimit dhe më në fund roli personal në projekt (hulumtues kryesor / ekspert, hulumtues / ekspert i lartë, hulumtues i ri/ ekspert, koordinator / menaxher i projektit, të tjera).

Profesorët dhe asistent pedagogët nga Universiteti European i Tiranës kanë marrë pjesë kryesisht në projekte kombëtare dhe evropiane, të zbatuara në 2016 dhe 2017 ose në mes të vitit 2008 dhe 2012. Gjithashtu u përmend një projekt rajonal (me fokus në Evropën Juglindore). Rolet që kishin ose ende zënë në këto projekte janë hulumtues / ekspert i lartë, hulumtues kryesor / ekspert ose koordinator / menaxher i projektit. Së fundi, kur bëhet fjalë për temat e projekteve, shumica e tyre nuk lidhen drejtpërdrejt me menaxhimin financiar dhe kontrollin. Për shembull, disa nga projektet e të anketuarve

ishin të përfshirë në ngritjen e kapaciteteve në arsimin e lartë, rritjen e kompetencave për sipërmarrjen, shkëmbimin e stafit dhe studentët etj. Megjithatë, kishte tre tema në lidhje të drejtpërdrejtë me fushëveprimin dhe qëllimin e projektit FINAC. Njëri ishte një projekt kombëtar në krijimin dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe aftësive të auditimit të brendshëm - tema e fundit ishte kushtuar krijimit të një baze metodologjike dhe monitorimit të funksionimit të shërbimit të auditimit të brendshëm, si dhe forcimit të rolit të njësisë qendrore të harmonizimit e auditimit të brendshëm. Projekti zgjati midis 2009 dhe 2011 dhe roli i të intervistuarit ishte koordinatori i projektit. Dy projekte të tjera kanë të bëjnë me buxhetimin me pjesëmarrje dhe përmirësimin e transparencës së buxhetit të shpenzimeve publike në nivel lokal përmes auditimit social. Të dyja projektet kishin shtrirje kombëtare, zgjatën nga viti 2016 deri në vitin 2017 dhe roli i të intervistuarit ishte hulumtues / ekspert i lartë.

Profesorët dhe asistentët nga Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" duket se kanë një përfshirje më të madhe me projektet evropiane dhe ndërkombëtare (vetëm një projekt kombëtar dhe një rajonal janë raportuar) krahasuar me profesorët nga Universiteti Europian i Tiranës të cilët ishin më shumë të fokusuar në projektet kombëtare. Sa i përket periudhës së zbatimit, këto projekte zgjatën më shumë (zakonisht për dy apo tre vjet midis 2011 dhe 2016). Në anën tjetër, në pjesën më të madhe të projekteve, profesorët dhe asistentët kishin rolin e hulumtuesit të ri, e ndjekur nga koordinatori / menaxher i hulumtuesit / ekspertëve dhe koordinatorëve të projektit (në Universitetin Europian të Tiranës më të shumtët ishin hulumtues / menaxher). Përfundimisht, sa i përket temave të aktiviteteve të zhvillimit profesional, situata është mjaft e ndryshme. Projektet që lidhen me sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë janë në shumicën, pasuar nga aktivitetet e krijimit të programeve të ndryshme master. Sidoqoftë, nuk janë raportuar tema të hulumtimit dhe zhvillimit që lidhen drejtpërdrejt me qëllimin dhe fushëveprimin e projektit FINAC.

Fushat e ekspertizës

Pjesa tjetër e pyetësorit ishte e lidhur me fushën e ekspertizës së profesorëve - iu kërkua që të emërojnë deri në pesë fusha më të rëndësishme të ekspertizës së tyre në lidhje të drejtpërdrejtë me nevojat e projektit FINAC. Listat e ekspertizës janë paraqitur në tabelat 2 dhe 3.

Tabela 2. Lista e ekspertizës së pedagogëve të UET të lidhur me projektin FINAC

Ekspertizë e lidhur me projektin FINAC		
Audit i brendshëm dhe i jashtëm	Manaxhimi Financiar dhe kontrolli	Kontabiliteti Publik
Programimi dhe Zbatimi i Buxhetit	Manaxhimi i Burimeve Njerëzore	Konkurrueshmëria dhe Financat
Buxhetim	Administrimi Publik	Financat Publike
Politika Publike	Shërbimi Civil	Manaxhimi i sektorit publik
Manaxhimi i Cilësisë në	Tregjet e Kapitaleve	Bankingu

Administratën Publike		
Ekonomi	Financimi	Manaxhimi i Biznesit
Qeverisje Korporatash	Manaxhimi dhe Marketingu	Huadhënia e Bankave
Metoda Kërkimi për Administratën Publike	Marketingu i Shërbimeve Publike	Politikat Ekonomike të Lidhura me Sektorin Publik

Tabela 3. Lista e ekspertizave të Universitetit "Luigj Gurakuqi" të lidhura me projektin FINAC

Ekspertizë e lidhur me projektin FINAC		
Manaxhim / Kontabilitet	Manaxhimi i Projekteve në Administratën Publike	Etika në kontabilitet
Drejtimi i Kostos së Kontabilitetit	Manaxhimi Ndërkombëtar	Audit financiar
Manaxhimi i Riskut	Prezantimi i rezultateve	Manaxhimi financiar
Decentralizimi Fiskal	Analiza e të dhënave	Administrata publike
Organizim takimesh me Administratën Publike	Komunikimi dhe etika profesionale	Manaxhimi i dijes dhe e drejta e autorit
Planifikimi	Manaxhimi i projekteve	Aftesi publikimi
Aftësia organizative e konferencave, trajnimeve brenda projektit	Vlerësimi dhe Kontrolli për Menaxhimin e Brendshëm të Ndërmarrjeve Decentralizimi	Strategjitë për zhvillimin ekonomik lokal
Metoda empirike për vlerësimin e politikës publike	Marketingu i territorit	Standardet kombëtare dhe ndërkombëtare
E-qeveria	Sjellja e investitorëve	Institucionet Financiare
Vlerësim Projekti	Tregjet financiare	Taksat dhe Administrimi i Taksave
Tregjet Financiare Ndërkombëtare		

Së bashku me listën e fushave të ekspertizës, profesorëve të universitetit dhe asistentëve u kërkua që të rendisnin tre botimet e tyre më të rëndësishme. Shuma e botimeve mund të gjendet në Aneksin I të këtij dokumenti si një listë referencash.

Nevoja për zhvillim profesional

Në pjesën përfundimtare të pyetësorit u kërkua që profesorët e universitetit të përshkruanin nevojat e tyre për zhvillim të mëtejshëm profesional në fusha të ndryshme relevante për projektin FINAC, përkatësisht në menaxhimin financiar dhe kontrollin në sektorin publik, auditimin, buxhetimin, kontabilitetin, politikën publike dhe administratën publike.

Fusha e parë për të cilën të anketuarit nga të dy universitetet u kërkua të shpjegonin nevojat e tyre për zhvillim profesional ishte Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli (MFK). Shumica e të anketuarve deklaruan se kanë nevojë për një lloj qasjeje holistike kur bëhet fjalë për trajnime të mëtejshme në MFK, që do të thotë se ata dëshirojnë të dinë më shumë për të gjitha elementet e MFK. Megjithatë, disa të anketuar ishin më specifikë. Për shembull, disa profesorë dhe asistentë shprehën nevojën për zhvillim të mëtejshëm profesional në fusha të tilla si mjedisi i kontrollit, aktivitetet e kontrollit dhe

menaxhimi i rrezikut. Menaxhimi financiar i të ardhurave dhe shpenzimeve në buxhetin e shtetit, planifikimi financiar, mbështetja financiare për investitorët e huaj dhe sistemi bankar u përmendën gjithashtu si fusha ku nevojiten trajnime të mëtejshme

Sfera e dytë ishte Auditimi në Sektorin Publik. Përsëri, si në rastin e mëparshëm, të anketuarit më së shumti deklaruan se dëshirojnë të dinë më shumë për të gjitha elementet e auditimit të brendshëm në sektorin publik. Interes të veçantë u tregua për teknikat e ndryshme të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, procedurat e auditimit të brendshëm, si dhe analizën dhe auditimin e pasqyrave financiare.

Element i tretë në këtë pjesë të pyetësorit ishte Buxheti në Sektorin Publik. Në këtë seksion, të anketuarit ishin pak më specifik në deklarimin e nevojave të tyre për zhvillim profesional. Disa nga fushat e përmendura si të rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm profesional janë monitorimi dhe vlerësimi i efektivitetit dhe efikasitetit të shpenzimeve të politikave publike, marrëdhëniet midis buxhetit dhe qeverisjes së mirë, sistemeve të buxhetimit të IT dhe lidhjes midis buxhetit dhe financave publike.

Kontabiliteti në sektorin publik ishte fusha e ardhshme e interesit dhe kjo ishte pjesa me numrin më të ulët të përgjigjeve. Shumica e të anketuarve shkruan se ata dëshirojnë të dinë më shumë për të gjitha aspektet e kontabilitetit, pa dhënë tema ose udhëzime specifike të cilat mund të tregojnë se ekspertiza ekzistuese në këtë fushë kryesisht mungon, e cila pritet, duke njohur profilin dhe fushën e ekspertizës së të anketuarve.

Së fundi, për temën e administratës publike dhe politikave publike, interesi për zhvillimin e mëtejshëm profesional ishte më i larti dhe përshkruhet në detaje. Të anketuarit dëshirojnë të dinë më shumë për menaxhimin e cilësisë në administratën publike, monitorimin dhe vlerësimin, qeverisjen elektronike, sistemet e informacionit, decentralizimin dhe planifikimin, dhe metodat e hulumtimit. Interesi ishte gjithashtu i lartë për trajnime shtesë në disa fusha të politikës publike siç janë llojet e tyre të ndryshme dhe zbatueshmëria, hartimi, zbatimi dhe kontrolli i politikave publike dhe metodologjitë e vlerësimit.

Përfundime

Ky studim me profesorët e universitetit në dy institucione partnere nga Shqipëria tregoi se ekspertiza e nevojshme për të arritur qëllimet e projektit në mënyrë efektive është shumë e pranishme. Kjo mund të shihet nga lista e lëndëve që ofrohen nga të anketuarit, arsimimi i tyre fillestar, lista e referencave dhe fushat e vetë-raportuara të ekspertizës të cilat janë shumë të rëndësishme për menaxhimin financiar, kontabilitetin dhe kontrollin. Profesorët e universitetit gjithashtu kanë përvojë të konsiderueshme me zhvillimin e mëtejshëm profesional dhe angazhimet në projektet e kërkimit dhe zhvillimit (në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare). Rezultatet, megjithatë, tregojnë se jo shumë prej këtyre përvojave ishin të lidhura drejtpërdrejt me temat më të rëndësishme me të cilat po merret projekti FINAC. Kjo në mënyrë të qartë përcjell mesazhin tek organet koordinuese dhe drejtuese të projektit që projekti FINAC duhet të përdoret gjerësisht si një instrument për zhvillimin e mëtejshëm profesional të mësuesve të përfshirë në universitet. Për këto qëllime vizitat studimore të organizuara me partnerët e konsorciumit të BE-së janë mundësi veçanërisht të fuqishme për mësim, por mundësitë e tjera duhet të merren parasysh gjithashtu. Në këtë kuptim, një sërë temash për zhvillim të mëtejshëm të propozuar nga profesorët e universitetit (të përshkruara në këtë raport) duhet të merren parasysh në përputhje me rrethanat.

Shtojca 1: Lista e referencave

Referenca nga UET

- Drishti, E., Kruja, D., & Curcija, M. (2016). An Evaluation of the Impact of Entrepreneurship Education on the Entrepreneurship Intentions in the Albanian Late Transition Context. In C. W. Colin, & A. Gurtoo, *Routledge Handbook of Entrepreneurship in Developing Economies* (pp. 463-487). Routledge.
- Druga, E., Qosja, E., & Qeli, E. (2016). Organizational culture and social capital in public health care institutions. *International Conference Days of Albanian Studies 2016*. Tirana: Universiteti European i Tiranes.
- Ismajli, N., Krasniqi, I., & Qosja, E. (2015). Career development and advancement of human resources –how they influence the performance qualities of local government administration. *Issues in Business Management and Economics*, 3, 17-23.
- Kokthi, E., & Kruja, D. (2016). Consumer expectations for geographical origin: eliciting willingness to pay (WTP) using the Disconfirmation of Expectation Theory (EDT). *Journal of Food Product Marketing*.
- Kokthi, E., & Kruja, D. (2016). Consumer Expectations for Geographical Origin: Eliciting Willingness to Pay (WTP) Using the Disconfirmation of Expectation Theory (EDT). *Journal of Food Products Marketing*, 1-17.
- Kokthi, E., Bermudez, I. V., & Limón, M. G. (2016). Predicting Consumer Willingness to pay for Geographical Origin in Albania: A Logistic Approach. *New Medit*, 15(2).
- Kokthi, E., Limón, M. G., & Bermúdez, I. V. (2015). Origin or Food Safety attributes? Analyzing consumer preferences using Likert Scale. Empiric evidences from Albania. *New Medit*, 14(4), 50-57.
- Kruja, D., Ha, H., Drishti, E., & Oelfke, T. (2016). Empowerment in the hospitality industry in the United States. *Journal of Hospitality Marketing & Management*, 25(1), 25-48.
- Miftari, G. (2016). Days of Albanian Studies. *Informality in Albania. Sector of Fason*. . Tirana.
- Miftari, G. (2016). Informality and Challenges of Fason sector' businesses. *Economicus*.
- Miftari, G., Korkuti, E., Lekaj, A., & Ndreu, F. (2015). Investor Psychology in Building Private Portfolios. *Prospects and Economic Challenges of the Generation*, 19-28.
- Muceku, H. (2014). Informal Economy in Albania - Its Costs In the Country Development. *Mediterranean Journal of Social Sciences*, 5(9).
- Muceku, H. (2014). The Development of Public Internal Financial Control in Albania - And His Role in Strengthening the Managerial Accountability. *Academic Journal of Interdisciplinary Studies*, 3(4).

- Muceku, H. (2017). The Albanian Taxpayers' Perception of Current Tax System and its Impact on Informal Economy. Tax evasion e Tax Avoidance. *Mediterranean Journal of Social Sciences*, 8(1).
- Ngjela, K., & Druga, E. (2016). Social and human risk and their impact on public reforms. *Publishing SAI*, 1267-279.
- Qosja, E., & Druga, E. (2014). The higher education institutional reform in Albania and its leadership style challenge. *The Macrotheme Review*, 3(9).
- Qosja, E., & Druga, E. (2015). Implementing a National Health Service model in the Albanian health care system. *The Macrotheme Review*, 4(6).
- Sahatcia, R., Qosja, E., & Ferhtataj, A. (2017). *Impact of Managerial Skills on the Efficiency and Effectiveness of Organisations - A Case for Albanian Business Organisations*. Retrieved from LSE: <http://www.lse.ac.uk/europeanInstitute/research/LSEE/Events/2016-2017/3rd-Research-Network-Conference/Presentations/Qosja%20-Sahatcia-%20ferhataj%20-%20Impact%20of%20Managerial%20Skills.pdf>
- Tabaku, E. (2014). An Overview of Marketing Means Used by Non-Profit Organizations: A Detailed Overview of NPOs Operating in the District of Elbasan. *Journal of Marketing and Management*, 4(2), 78-95.
- Tabaku, E. (2015). An investigation of mobile telephony customers in Albania. *The Macrotheme Review*, 4(6), 144-155.
- Tabaku, E. (2015). Brand loyalty and loyalty programs; a literature review. *Romanian Economic Business Review*, 10(2), 71-86.
- Ymeraj, A. (2010). Public services—theoretical concept or social responsibility? *Optime*, 1.
- Ymeraj, A. (2011). *The right to Labour and Social Security—Social Welfare Policies*. Tirana: PEGI Publishing .
- Ymeraj, A. (2015). Boosting growth through social business in former communist countries: a state's or a market function. *Economicus*, 28-35.

Referenca nga Universiteti "Luigj Gurakuqi"

- Barbullushi, E. (2015). Implication and application of Economic value added in banking system. *International Journal of Economics, Commerce and Management*, 3, 1-15.
- Barbullushi, E., & Boshti, S. (2015). Albanian economy toward official euroisation. *Journal of EuroEconomica, University of Galati*, 29-38.
- Barbullushi, E., & Dhuci, O. (2015). Albanian banking efficiency analysis: DEA approach. *SEERC*, (pp. 130-143). City College International Faculty of University of Sheffield.
- Boriçi, A. B. (2012). Staffing policies for managers in foreign companies in Albania, Monograph in English, Editor D&U, pressed by “Rozafa 1”. ISBN: 987-9928-4087-4-7.

- Boriçi, A. B., & Çelepija, J. (2014). Expatriates difficulties and failure in foreign companies operating in Albania. *International Journal of Economics, Commerce and Management*, 2(1).
- Boriçi, A. B., Boriçi, A., & Dergjini, A. (2012). The impact of the euro zone debt crisis in subsidiaries' strategies of MNEs operating in Albania. *International Conference on Economic Development and Standard of Living EDASOL*. Banja Luka: Faculty of Economy, University of Banja Luka.
- Bushati, B. (2012). Control Of Mergers And Acquisition, It'S Impact In The Market Development In Albania. *Journal of US-China Public Administration*, 9(3).
- Bushati, B. (2015). The importance of information technology in Business management process. *ISSN 2281-4612*, 4(2).
- Bushati, B. (2017). Handicrafts as an Opportunity for Economic Development and Sustainable Tourism: Case study Shkodra Region. *ISSN 2476-3160*, 4.
- Dionizi, B. (2015). Milk Processing Companies and Quality Elements, Case of Albania. *International Multidisciplinary Conference, organized by IJAS*. Vienna.
- Dionizi, B., & Kërçini, D. (2015). Strategic Planning, specifics for SMEs. *7th International Scientific Conference*. Montenegro.
- Dionizi, B., & Kërçini, D. (2015). Thinking Strategically in Agribusiness, case of Albania. *QUAESTI, Virtual Multidisciplinary International Conference*. Slovakia.
- Dragusha, B., & Kinka, A. (2011). Foreign Direct Investments in Albania. *European Scientific Journal*, 5-19.
- Education and Social Sciences – Global Challenge 2017. (2017). International Institute for Private, Commercial and Competition Law.
- Entrepreneurship Drivers. (n.d.). *Academic Literature Scientific Bulletin*, 35-45.
- Kalaj, E. (2013). Do Remittances Alter Labor Market Participation? *Journal for Labor and Social Affairs in Eastern Europe*, 16, 417-432.
- Kalaj, E. H. (2015). micro-level analysis of the effect of remittances on health expenditures: Evidence from Albania. *Mediterranean Journal of Social Sciences*, 6(1), 665.
- Kastrati, A. (2015). The quality of accounting information and financial report after the application of national accounting standards in Albania.
- Kastrati, A. (2016). Financial reporting in Albania and Kosovo - A literature review. *International Journal of Economics, Commerce and Management*, 541-548.
- Kastrati, A., & Shala, S. (2012). Public Accounting and Budget of Shkoder Municipality. *Bulletin of the University of Shkoder*, 35-41.
- Kinka, A., & Dragusha, B. (2011). Social Responsibility of Business in Albania. *European Scientific Journal*, 69-81.
- Kinka, A., & Dragusha, B. (2012). The Effects of EU Integration on the Fiscal Decentralization Process in Western Balkan Countries. *Scientific Magazine of the Center for Scientific Economic Research*.
- Kiri, N. (2016). Efficiency of tax administration: case of Shkodra Regional Tax Directorate. *International Journal of Economics, Commerce and Management*, 4(5), 218-224.

- Kiri, N. (2016). Factors affecting tax evasion. *International Journal of Economics, Commerce and Management*, 4(2), 804-811.
- Kiri, N. (2016). Performance of tax administration in Albania years: 2010-2014. *International Journal of Economics, Commerce and Management*, 4(1), 519-524.
- Kruja, D., Drishti, E., & Curcija, M. (2016). An evaluation of the impact of entrepreneurship education on the entrepreneurship intentions in the Albanian late transition context. In C. C. Williams, & A. Gurtoo, *Routledge Handbook of Entrepreneurship in Developing Economies* (pp. 463-486). Abingdon: Routledge.
- Molla, F. (2012). The role of standardizing accounting information in the financial analysis of economic units. *European Scientific Revival*, 8(5).
- Molla, F. (2015). Analysis of the labor market in Albania. *Journal of International Academic Research for Multidisciplinary*, 278-285.
- Molla, F. (2015). Risk management in business entities of Albania. *REFORMA*, 244-248.
- Shahini, E., & Kalaj, E. (2016). The institutional effect on public health: An Albanian survey analysis. *SEER Journal for Labour and Social Affairs in Eastern Europe*, 19(1), 99-108.
- Troshani, A. (2005). A focus on Shkodra Region: Challenges of Public Administration. Experiences of STRIDE 1. *ISSN: 1396-5085*, 43-48.
- Troshani, A., & Cudmore, A. (2009). Entrepreneurial investment in the Shkodra region: opportunities for women in Tourism. Academy of Entrepreneurship "Entrepreneurial Executive". *ISSN: 1087-8955*, 14.
- Troshani, A., & Zürcher, D. (2007). Capacity building through research partnership. A case study on decentralization and governance in Northern Albania. *No31, ISSN: 1662-7504*.

FINAC

Menaxhimi financiar, kontabiliteti dhe kontrolli i zhvillimit të kapaciteteve të administratës publike

Kjo anketë është përgatitur në kuadër të projektit Menaxhimi financiar, kontabiliteti dhe kontrolli i zhvillimit të kapaciteteve të administratës publike (FINAC) sipas programit të BE-së ERASMUS+, nënprogramit *Ngritje Kapacitetesh në Arsimin e Lartë*. Synimi kryesor i projektit është të kontribuojë në rritjen e cilësisë të buxhetimit, menaxhimit të parave, menaxhimit financiar, kontabilitetit dhe kontrollit në administratën publike. Ky qëllim do të arrihet duke zhvilluar/modernizuar programet e diplomave të masterit dhe realizimit të trainimeve për punonjësit e administratës publike në fushën e menaxhimit financiar, kontabilitetit dhe kontrollit.

Projekti implementohet në Shqipëri dhe Serbi dhe bashkëpunimi i projektit përfshin 12 partnerë (nga Shqipëria, Serbia dhe katër shtete të BE-së). Institucioni Koordinues i projektit FINAC është Universiteti i Beogradit, Fakulteti i Shkencave Organizative. Më shumë informacion rreth projektit mund të gjendet në adresën <http://www.finac.org.rs>

Qëllimi kryesor i kësaj ankete është mbledhja e informacionit rreth ekspertizës së profesorëve në universitetet rajonale partnere dhe perceptimit të nevojave për zhvillimin e tyre profesional gjë e cila do të udhëhiqte 1) zhvillimin e programeve të reja master dhe trajnimeve gjatë kohës së punësimit në fushën e administrimit publik dhe 2) hartimi i aktiviteteve profesionale të zhvillimit të cilat do t'ju ofrohen profesorëve të universiteteve rajonale partnere nga universitetet partnere të FINAC BE.

Ky pyetësor kërkon disa informacione të cilat do të ishte mirë të përgatiteshin paraprakisht. Në e-mailin nëpërmjet të cilit jeni ftuar të merrni pjesë në këtë anketë, gjithashtu ju keni marrë pyetësorin në formatin PDF. Nëse nuk e keni bërë ende, ju këshillojmë t'i hidhni një vështrim formatit PDF dhe të përgatisni të dhënat me të cilat do të plotësoni pyetësorin në vijim.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin tuaj!

A1. Cila është përkatësia juaj akademike (emërimi parësor)?

Universiteti: _____

Fakulteti: _____

Departamenti: _____

A2. Cila është përkatësia juaj akademike dytësore (nëse ka)?

Universiteti: _____

Fakulteti: _____

Departamenti: _____

A3. Cili është titulli juaj?

- a. Profesor
- b. Profesor i asociuar
- c. Asistent profesor
- d. Asistent në mësimdhënie

A4. Cilat lëndë jepni mësim?

Në nivelin BA (lëreni bosh nëse nuk jepni mësim në këtë nivel)

Lënda 1: _____

Lënda 2: _____

Lënda 3: _____

Lënda 4: _____

Lënda 5: _____

Në nivelin MA (lëreni bosh nëse nuk jepni mësim në këtë nivel)

Lënda 1: _____

Lënda 2: _____

Lënda 3: _____

Lënda 4: _____

Lënda 5: _____

Në nivelin PhD (lëreni bosh nëse nuk jepni mësim në këtë nivel)

Lënda 1: _____

Lënda 2: _____

Lënda 3: _____

Lënda 4: _____

Lënda 5: _____

II NEVOJAT PËR ZHVILLIM PROFESIONAL

Përmes projektit FINAC, institucionet partnere të BE-së do të zhvillojnë trajnime për mësuesit e shteteve të rajonit. Për këtë qëllim, është e rëndësishme të mësohet rreth çështjeve specifike rreth të cilave mësuesit e shteteve të rajonit janë më shumë të interesuar për të përditësuar aftësitë e tyre. Ju lutem të jini sa më specifik të jetë e mundur në fushat kyçe në vazhdim dhe plotësoni ato fusha të cilat gjenden më afër fushës tuaj të ekspertizës.

B1. Manaxhimi financiar dhe kontrolli në sektorin publik

B2. Auditimi në sektorin publik

B3. Buxhetimi në sektorin publik (programimi dhe implementimi)

B4. Kontabiliteti në sektorin publik

B5. Administrimi publik & politika publike

III EDUKIMI FILLESTAR

C. Ju lutem jepni informacion për secilin nga nivelet e edukimit tuaj zyrtar

C1. Diplomë universitare e nivelit të parë

Universiteti: _____

Fakulteti: _____

Nëse keni më shumë se një diplomë të këtij niveli, ju lutem jepni gjithashtu informacion për atë diplomë.

C2. Diplomë universitare e nivelit të dytë (magjisteri / master / specializim)

Universiteti: _____

Fakulteti: _____

Nëse keni më shumë se një diplomë të këtij niveli, ju lutem jepni gjithashtu informacion për atë diplomë.

C3. Diplomë universitare e nivelit të tretë (PhD)

Universiteti: _____

Fakulteti: _____

Nëse keni më shumë se një diplomë të këtij niveli, ju lutem jepni gjithashtu informacion për atë diplomë.

Nëse jeni ende student i shkollës akademike doktorale, ju lutem shënoni vitin e regjistrimit _____

IV ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËTEJSHËM

D. Ju lutem jepni informacion për 3 aktivitetet e zhvillimit profesional më të rëndësishme që keni pasur deri tani

D1. Aktivitet I zhvillimit profesional 1:

- Lloji i aktivitetit: _____
(p.sh. kërkime pas doktorature, bursa, programe shkëmbimi, trajnime...)
- Institucioni organizator (përgjegjës për përmbajtjen akademike/profesionale): _____
- Shteti në të cilin u zhvillua aktiviteti: _____
- Çështjet kryesore të aktivitetit: _____
- Kohëzgjatja e aktivitetit:
 - a. Deri në një javë
 - b. Midis një jave dhe një muaji
 - c. Midis një muaji dhe gjysëm viti
 - d. Midis gjysëm viti dhe një vit
 - e. Më shumë se një vit
- Viti në të cilin përfundoi aktiviteti: _____

D2. Aktivitet I zhvillimit profesional 2:

- Lloji i aktivitetit: _____
(p.sh. kërkime pas doktorature, bursa, programe shkëmbimi, trajnime...)
- Institucioni organizator (përgjegjës për përmbajtjen akademike/profesionale): _____

- Shteti në të cilin u zhvillua aktiviteti: _____
- Çështjet kryesore të aktivitetit: _____
- Kohëzgjatja e aktivitetit:
 - f. Deri në një javë
 - g. Midis një jave dhe një muaji
 - h. Midis një muaji dhe gjysëm viti
 - i. Midis gjysëm viti dhe një vit
 - j. Më shumë se një vit
- Viti në të cilin përfundoi aktiviteti: _____

D3. Aktivitet I zhvillimit profesional 3:

- Lloji i aktivitetit: _____
(p.sh. kërkime pas doktorature, bursa, programe shkëmbimi, trajnime...)
- Institucioni organizator (përgjegjës për përmbajtjen akademike/profesionale):

- Shteti në të cilin u zhvillua aktiviteti: _____
- Çështjet kryesore të aktivitetit: _____
- Kohëzgjatja e aktivitetit:
 - k. Deri në një javë
 - l. Midis një jave dhe një muaji
 - m. Midis një muaji dhe gjysëm viti
 - n. Midis gjysëm viti dhe një vit
 - o. Më shumë se një vit
- Viti në të cilin përfundoi aktiviteti: _____

V PJESËMARRJA NË PROJEKTE KËRKIMI DHE ZHVILLIMI

E. Ju lutem jepni informacion rreth pjesëmarrjes në 3 projekte më të rëndësishme kërkimi dhe/ose zhvillimi në të cilat keni marrë pjesë deri tani.

E1. Projekti 1

- Titulli i projektit: _____
- Çështjet kryesore: _____
- Periudha e implementimit: _____ - _____
- Qëllimi i projektit:
 - a. Kombëtar
 - b. Rajonal (Evropa Jug-Lindore)
 - c. Evropian
 - d. Ndërkombëtar (përtej Evropës)
- Roli personal në projekt:
 - a. Kërkues/ekspert lider
 - b. Kërkues/ekspert i lartë
 - c. Kërkues/ekspert i ri

- d. Koordinator/manaxher projekti
- e. Tjetër

E2. Projekti 2

- Titulli i projektit: _____
- Çështjet kryesore: _____
- Periudha e implementimit: _____ - _____
- Qëllimi i projektit:
 - a. Kombëtar
 - b. Rajonal (Evropa Jug-Lindore)
 - c. Evropian
 - d. Ndërkombëtar (përtej Evropës)
- Roli personal në projekt:
 - f. Kërkues/ekspert lider
 - g. Kërkues/ekspert i lartë
 - h. Kërkues/ekspert i ri
 - i. Koordinator/manaxher projekti
 - j. Tjetër

E3. Projekti 3

- Titulli i projektit: _____
- Çështjet kryesore: _____
- Periudha e implementimit: _____ - _____
- Qëllimi i projektit:
 - a. Kombëtar
 - b. Rajonal (Evropa Jug-Lindore)
 - c. Evropian
 - d. Ndërkombëtar (përtej Evropës)
- Roli personal në projekt:
 - k. Kërkues/ekspert lider
 - l. Kërkues/ekspert i lartë
 - m. Kërkues/ekspert i ri
 - n. Koordinator/manaxher projekti
 - o. Tjetër

VI FUSHA E EKSPERTIZËS

F. Ju lutem listoni deri në 5 fusha të ekspertizës tuaj profesionale (në lidhje me qëllimin e projektit FINAC):

- F1. Ekspertiza 1: _____
- F2. Ekspertiza 2: _____
- F3. Ekspertiza 3: _____
- F4. Ekspertiza 4: _____
- F5. Ekspertiza 5: _____

VII PUBLIKIMET KRYESORE

G. Ju lutem jepni informacion për 3 publikimet tuaj më të rëndësishme. Ju lutem jepni 3 referenca të plota në stilin APA (shihni udhëzimet e përgjithshme në këtë faqe <https://owl.english.purdue.edu/owl/resource/560/06/>). Nëse një tekst është në gjuhën vendase, jepni referencën origjinale në gjuhën vendase dhe referencën e përkthyer në Anglisht.

G1. Referenca 1:

G2. Referenca 2:

G3. Referenca 3:

Ju falenderojmë për bashkëpunimin tuaj!